



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVA
Komuna e Rahovecit/ Opština Orahovac/Municipality Rahovec



Kuvendi Komunal / Skupština Opštine / Muncipal Rahovec

Në bazë të nenit 12, nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës nr. 03/L-40, Nenit 2, nenit 5, të Statutit të Komunës së Rahovecit 01Nr 569/1 i dt. 16.12.2010 , nenit 6.4 të Rregullores për ndarjen e Subvencioneve 01Nr.1830 të datës 30.04.2013, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur më 26 Korrik 2016, merr këtë :

V E N D I M

- I. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës së Rahovecit me Nr. të protokollit 348 të datës 25.07.2016 të Shoqatës HardhFest mbi subvencionimin e festës për vjeljen e rrushit “ **HardhFest 2016** ” dhe ti ndahet shuma prej 8,000.00 € (tetëmijë Euro).
- II. Shoqata HardhFest subvencionohet në bazë Rregullores për ndarjen e Subvencioneve 01 Nr. 1830 të datës 30.04.2013, me qëllim të përkrahjes së aktivitetit të tyre, festës për vjeljen e rrushit.
- III. Festa për vjeljen e rrushit “ **HardhFest 2016** ” ka marr karakter tradicional dhe është dëshmuar si festival i vlerave të mirëfillta të vjeljes së rrushit ku në këtë festë marrin pjesë shumë vreshtar nga gjithë rajoni.
- IV. Mjetet do të sigurohen nga subvencionet e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
- V. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdesen Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
- VI. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në Web – faqen zyrtare të Komunës së Rahovecit.

KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT

01.Nr. 2365
Rahovec, 26.07.2016

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. i prot. 2365 Më 26.07 2016
Br. prot. Dt. RAHOVEC - ORAHOVAC



Kryesuesi i Kuvendit
Nahit Elshani